VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT - 2018

Nr. 60 Prot
23.07.2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT**
**Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin**

# VENDIM

**Nr. 481 L datë 13.07. 2018**

**Për**

**Miratimin e kërkesës për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "Alb Green Electricity" ,për shfrytëzimin e përroit te Sopotit dhe burimeve të tij,degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Prrenjas për ndërtimin e HEC SOPOTI, për qëllime hidroenergjie.**

Në mbështetje te ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d , neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Per miratimin e kushteve të pergjithshme e të posaçme, dokumentave shoqëruse, afatit të vlefshmërise, formularve të aplikimit për autorizime dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit Nr.5 datë 16.02.2016 të Keshillit Kombëtare të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe fuksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 të Këshillit Kombëtar të Ujit "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor",

Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin .

**VENDOSI:**

**Mos miratimin e kërkesës për marrje leje "Miratim në parim" subjektit "Alb Green Electricity", për shfrytëzimin e përroit te Sopotit dhe burimeve të tij,degë e lumit Shkumbin, në Bashkinë Prrenjas për ndërtimin e HEC SOPOTI, për qëllime hidroenergjie.**

***Të dhënat e HEC SOPOTI janë*** :

Kordinatat e marrjes së ujit :

**X 44 41 902** **Y 45 45 528** **Z 980** *m m.n.d*

*Prurja ekologjike* *0.07 $m^3$/sek*
*Prurja e llogaritur* *1.0 $m^3$/sek*

***Godina e HEC SOPOTI***

**X 44 40 746** **Y** **45 45 501** **Z 710** *m m.n.d*

*Fuqia e HEC-it* *1,995MW*

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- Të mos cënoj furnizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të perspektivës.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (l/s) për cdo vit të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendor dhe atij Qendror.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës kur e kërkon Bordi i Kullimit .
- Të respektojë rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe duke plotësuar kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËS ABU**

**SHKUMBIN**

**Dashamir BIÇAKU**

**KRYETARI I KBU**

**SHKUMBIN**

**Maksim MALAJ**